



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

PROGRAMI: MASTER I SHKENCËS NË MENAXHIM TË RISKUT DHE SIGURIMET (MSc.)

Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit:	Menaxhim i Riskut dhe Sigurimet
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Arsimi i lartë – Cikli i dytë i Bolonjës (Master) MSc. Niveli i 7-të, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK);
Grada akademike (kualifikimi i fituar):	Master i Shkencës në Menaxhim të Riskut dhe Sigurimet (MSc.)
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC):	04 (04.0 dhe 04.9) Program Interdisciplinar Studimi
Kohëzgjatja minimale e studimit:	2 vite, 4 semestra
Forma e studimit:	Studime të rregullta
Numri i ECTS kredive:	Gjithsej 120 ECTS, për një vit 60 ECTS
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Qëllimi i programit <i>Menaxhim i Riskut dhe Sigurimet</i> është të përgatisë profesionistë të aftë për të identifikuar, analizuar dhe menaxhuar rreziqet në sektorin e sigurimeve dhe në organizata të tjera ekonomike. Programi synon t'u zhvillojë studentëve njohuri të avancuara në vlerësimin e rrezikut, analizën financiare dhe procesin e vendimmarrjes, duke i pajisur ata me aftësi praktike dhe të menduarit kritik për t'u përballur me sfidat dhe tendencat bashkëkohore në fushën e menaxhimit të rrezikut. Përfundimisht, programi synon të kultivojë specialistë profesionalë që kontribuojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e praktikave të sigurimeve dhe menaxhimit të rrezikut në treg. Programi <i>Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimet</i> synon: 1. Të ofrojë njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi parimet, funksionet dhe rregulloret që udhëheqin industrinë e sigurimeve dhe menaxhimin e rrezikut. 2. Të zhvillojë aftësi profesionale në identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve në sektorë dhe organizata të ndryshme. 3. Të pajisë studentët me kompetenca për hartimin dhe zbatimin e strategjive të menaxhimit dhe zbutjes së rrezikut, duke përdorur qasje analitike dhe modele të bazuara në të dhëna.

	4. Të nxisë mendimin kritik, kreativ dhe aftësitë në zgjidhjen e problemeve brenda kontekstit dinamik të tregjeve financiare dhe sigurimeve. 5. Të promovojë zhvillimin kërkimor dhe bashkëpunues, duke inkurajuar studentët të integrojnë teori, praktikë dhe qasje ndërdisiplinore. 6. Të përgatisë profesionistë të aftë për tregun global, duke theksuar përshtatshmërinë, etikën dhe mësimin gjatë gjithë jetës.
Rezultatet e pritshme të të nxënit:	Pas përfundimit me sukses të programit, studenti do të jetë në gjendje të: 1. Shpjegojë në mënyrë të qartë parimet, strukturat dhe funksionet e industrisë së sigurimeve dhe menaxhimit të rrezikut. 2. Identifikojë dhe analizojë lloje të ndryshme të rreziqeve në mjedise organizative dhe tregjeve financiare. 3. Përdorë metoda dhe mjete analitike për vlerësimin sasior dhe cilësor të rrezikut dhe ndikimeve të tij. 4. Hartojë politika dhe strategji të menaxhimit të rrezikut, duke propozuar mënyra efektive për reduktimin, transferimin ose mbulimin e rrezikut. 5. Vlerësojë produktet e sigurimit si instrumente për stabilitet financiar dhe mbrojtje nga rreziku në nivel individual dhe organizativ. 6. Aplikojë standardet ligjore dhe rregullatore në sektorin e sigurimeve dhe rrezikut në përputhje me kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar. 7. Zhvillojë dhe prezantojë kërkime shkencore duke përdorur metodologji akademike të sakta dhe argumentim profesional. 8. Komunikojë në mënyrë efikase dhe profesionale me aktorë të tregut, organizata publike dhe private. 9. Demonstrojë aftësi lidhësi, bashkëpunimi dhe përgjegjshmërie etike në mjedise pune dhe vendimarrje të ndërlukuara.
Procedurat e mësimdhënies:	Procesi i mësimdhënies realizohet në bazë të parimeve të qasjes studenti-në-qendër dhe të ndërthurjes së teorisë me praktikën. Procedurat bazohen në standardet e arsimit të lartë dhe synojnë garantimin e cilësisë së të nxënit. Procedurat përfshijnë: 1. Ligjëratat teorike – Prezantimi i koncepteve, modeleve dhe parimeve themelore të fushës. – Përdorimi i mjeteve vizuale, shembujve praktikë dhe literaturës relevante. – Sigurimi i qartësisë dhe strukturimit të temave sipas planit mësimor. 2. Seminare dhe diskutime të udhëhequra – Analizimi kritik i rasteve konkrete nga praktika e sigurimeve dhe menaxhimit të rrezikut. – Inkurajimi i dialogut, reflektimit teorik dhe krahasimeve ndër-

	sektoriale. 3. Mësimi i bazuar në raste (Case Study) – Studim dhe interpretim i ngjarjeve reale të tregut të sigurimeve. – Identifikimi i problemeve dhe propozimi i zgjidhjeve strategjike. 4. Projekte individuale dhe në grup – Hartimi i analizave profesionale dhe raporteve kërkimore. – Zhvillimi i aftësive të punës bashkëpunuese dhe komunikimit akademik. 5. Praktika profesionale – Vendosja e studentëve në institucione financiare, kompani sigurimesh, agjenci rregullatore, etj. – Monitorim, vlerësim dhe raportim i përvojës praktike. 6. Ndërhurja e kërkimit me mësimdhënien – Përdorimi i literaturës shkencore bashkëkohore. – Inkurajimi i studentëve për publikime, konferenca dhe punime finale me karakter studimor. 7. Vlerësimi i vazhdueshëm – Detyra, seminare, teste, prezantime dhe punë kërkimore. – Vlerësim objektiv sipas kriterëve të qarta dhe transparente.																						
Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve);	Metodat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lëndë mësimore veç e veç në kuadër të programit. Një shembull i vlerësimit është si më poshtë: <table> <tr> <td>Punimi shkencor:</td><td>40%</td></tr> <tr> <td>Testi i parë vlerësues:</td><td>30%</td></tr> <tr> <td>Testi i dytë vlerësues:</td><td>30% ose</td></tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar:</td><td>60%</td></tr> <tr> <td>Total</td><td>100%</td></tr> </table> Kurse, një shembull i kriterit të notimit është si në vijim: <table> <tr> <td>0-50.99%</td><td>(5)</td></tr> <tr> <td>51-60.99%</td><td>(6)</td></tr> <tr> <td>61-70.99%</td><td>(7)</td></tr> <tr> <td>71-80.99%</td><td>(8)</td></tr> <tr> <td>81-90.99%</td><td>(9)</td></tr> <tr> <td>91-100%</td><td>(10)</td></tr> </table>	Punimi shkencor:	40%	Testi i parë vlerësues:	30%	Testi i dytë vlerësues:	30% ose	Provimi përfundimtar:	60%	Total	100%	0-50.99%	(5)	51-60.99%	(6)	61-70.99%	(7)	71-80.99%	(8)	81-90.99%	(9)	91-100%	(10)
Punimi shkencor:	40%																						
Testi i parë vlerësues:	30%																						
Testi i dytë vlerësues:	30% ose																						
Provimi përfundimtar:	60%																						
Total	100%																						
0-50.99%	(5)																						
51-60.99%	(6)																						
61-70.99%	(7)																						
71-80.99%	(8)																						
81-90.99%	(9)																						
91-100%	(10)																						
Modulet /Lëndët (titujt):	<u>Viti I</u> 1. Teoria dhe Praktika e Menaxhimit të Riskut 2. Direktivat e BE-së për Qeverisjen e Riskut 3. Financat e Avancuara të Korporatave 4. Menaxhimi i Riskut të Investimeve 5. Kontabiliteti i Kompanive të Sigurimit 6. Menaxhimi i Riskut Bankar 7. Analiza e të Dhënave dhe Ekonometria e Avancuar 8. Menaxhimi i Avancuar i Riskut të Ndërmarrjes 9. Fondet Pensionale 10. Menaxhimi i Kompanive të Sigurimit																						

	11. Ndërmarrësia e Gjelbër 12. Sigurimet Jetë dhe Jo - Jetë <u>Viti II</u> 1. Menaxhimi i Dëmeve 2. Qeverisja Mjedisore, Sociale dhe Korporative (ESG) 3. Auditimi Menaxherial 4. Mësimi Praktik dhe Zhvillimi i Karrierës 5. Menaxhimi i Riskut në Sektorin Publik 6. Risigurimet 7. Punimi i diplomës Master
Numri i vendeve të studimit:	50 student të rregullt
Udhëheqës i drejtimit/programit të studimit:	Prof. Dr. Halit Shabani Prof. Dr. Ibish Mazreku Prof. Dr. Afrim Selimaj
Personeli i përhershëm shkencor/artistik: (Numri sipas kategorive të personelit)	5 profesorë të rregullt, 3 profesorë të asocuar, 17 profesorë asistent, 7 asistentë.
Taksat e studimit:	Të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Studimet janë falas. Vërejtje: Në rast kur përsëritet viti, bëhet pagesa sipas Udhëzimit Administrativ MASHTI Nr.09/2021.
Mundësitë e punësimit pas diplomimit:	1. Industri e Sigurimeve – Analist i rrezikut (Risk Analyst) – Menaxher i portofolit të sigurimeve – Konsulent për produkte sigurimi dhe menaxhim të rrezikut 2. Institucione Financiare dhe Bankare – Analist financiar – Menaxher i riskut financiar – Specialist për përputhshmërinë dhe rregulloret 3. Kompani dhe Organizata Private – Konsulent për menaxhimin e rrezikut në projekte dhe investime – Menaxher i sigurimeve dhe mbulimeve të riskut – Specialist i kontrollit të brendshëm dhe auditimit të rrezikut 4. Institucione Publike dhe Rregullatore – Analist ose këshilltar i politikave për menaxhimin e rrezikut – Specialist në agjenci të mbikëqyrjes së tregut financiar dhe të sigurimeve – Konsulent për zhvillimin e standardeve dhe rregulloreve të sigurimeve, etj.